



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim
Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësi i Vetëm

Gjykatës Kristofer Gosnell

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 22 dhjetor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Zhvillimin e Gjykimit

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

**Zyrës për Mbrojtjen dhe
Mbështetjen e Dëshmitarëve**
Shefit të Zyrës për Mbrojtjen dhe
Mbështetjen e Dëshmitarëve

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Edwards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
Dejvid Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

I.	HISTORIKU PROCEDURAL	2
II.	DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE.....	3
III.	DISKUTIM.....	4
A.	Karakter i publik i procedurave.....	4
B.	Gjuha e punës.....	5
C.	Nxjerrja e materialeve dhe kufizimet ndaj nxjerrjes së materialeve	6
D.	Radha e paraqitjes së provave.....	6
E.	Provat që nuk janë pjesë e dëshmime.....	6
F.	Dëshmitarët.....	7
1.	Masat mbrojtëse	7
2.	Informimi i dëshmitarëve.....	8
3.	Marrja në pyetje me videokonferencë dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve jashtë vendit ku mbahet gjykimi.....	9
4.	Marrja në pyetje e dëshmitarëve	9
5.	Dëshmitarët ekspertë	13
6.	Vetinkriminimi i dëshmitarit	13
G.	Evidentimi i përdorimit të kohës.....	13
H.	Pjesëmarrja nga distanca e të akuzuarve	14
I.	Dosjet Gjyqësore Përfundimtare.....	15
J.	Sistemi <i>Legal Workflow</i>	15
IV.	VENDIM.....	15

GJYKATËSI I VETËM, në bazë të nenit 40(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 116(1) dhe (3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.¹

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 17 nëntor 2025, Gjykatësi i Vetëm ftoi palët dhe Zyrën Administrative/Zyrën për Mbrojtjen dhe Mbështetjen e Dëshmitarëve ("ZMMD") të dorëzonin parashtrime mbi aspekte të ndryshme të lidhura me zhvillimin e gjykimit.²

2. Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dhe Zyra Administrative/ZMMD-ja³ i dorëzuan parashtrimet e tyre më 20 nëntor 2025,⁴ ndërsa Mbrojtja e Hashim Thaçit ("Mbrojtja e Thaçit"), Mbrojtja e Bashkim Smakajt ("Mbrojtja e Smakajt"), Mbrojtja e Isni Kilajt ("Mbrojtja e Kilajt"), Mbrojtja e Fadil Fazliut ("Mbrojtja e Fazliut") dhe Mbrojtja e Hajredin Kuçit ("Mbrojtja e Kuçit") i dorëzuan parashtrimet e tyre më 24 nëntor 2025.⁵

¹ Të gjitha referencat ndaj "nenit" dhe "rregullës" do të kuptohen, përveç nëse tregohet ndryshe, si referime ndaj Ligjit dhe Rregullores.

² KSC-BC-2023-12, F00549, [Order Scheduling the Trial Preparation Conference and Requesting Submissions](#), (Urdhër për Caktimin e Datave për Mbajtjen e Konferencës Përgatitore për Gjykim dhe për Kërkim të Parashtrimeve) 17 nëntor 2025, publik, para. 12(3)(viii).

³ KSC-BC-2023-12, F00558, Administratorja, *Parashtrime të Administratores për Konferencat Përgatitore për Gjykim*, 20 nëntor 2025, publike, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁴ KSC-BC-2023-12, F00559, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë sipas F00549-ës*, 20 nëntor 2025, konfidenciale; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 26 nëntor 2025.

⁵ KSC-BC-2023-12, F00568, Mbrojtja e Thaçi, *Parashtrime të Mbrojtjes së Thaçit për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e Thaçit"), 24 nëntor 2025, konfidenciale; F00565, Mbrojtja e Smakajt, *Parashtrime të Mbrojtjes së Smakajt për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e Smakajt"), 24 nëntor 2025, konfidenciale; F00569, Mbrojtja e Kilajt, *Parashtrime të Mbrojtjes së Kilajt për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e Kilajt"), 24 nëntor 2025, publik; F00570, Mbrojtja e Fazliut, *Parashtrime të Fazliut për Konferencën Përgatitore për Gjykim* ("Parashtrimet e Fazliut"), 24 nëntor 2025, publik; F00567, Mbrojtja e Kuçit, *Parashtrime të Mbrojtjes së Kuçit për Konferencën Përgatitore për Gjykim*, 24 nëntor 2025, konfidenciale.

3. Më 28 nëntor 2025, Gjykatësi i Vetëm mbajti konferencën përgatitore për gjykimin dhe konferencën përgatitore të Prokurorit të Specializuar, gjatë të cilave u bënë parashtrime gojore të tjera shtesë lidhur me zhvillimin e gjykimit.⁶
4. Më 4 dhjetor 2025, ZPS-ja dorëzoi parashtrime në lidhje me informimin dhe përgatitjen e dëshmitarëve.⁷
5. Të njëjtën ditë, Gjykatësi i Vetëm planifikoi fillimin e gjykimit për më 24 shkurt 2026, dhe përcaktoi disa afate të tjera.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të rregullës 116(3), “para hapjes së çështjes dhe pasi të ketë dëgjuar palët”, Gjykatësi i Vetëm “mund të japë udhëzime të nevojshme për kryerjen e procedurave që garantojnë një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe të shpejtë.”
7. Neni 40(2) i kërkon Gjykatësit të Vetëm të “sigurojë që shqyrtimi gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë dhe që procedurat të zhvillohen në pajtim me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave, në respekt të plotë të drejtave të akuzuarit dhe duke i kushtuar kujdesin e duhur mbrojtjes së dëshmitarëve.” Në bazë të së njëjtës dispozitë, Gjykatësi i Vetëm mund “të miratojë procedura dhe modalitete që janë të nevojshme për të mundësuar zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave” dhe “mund të japë udhëzime për zhvillimin e procedurave të drejta dhe të paanshme dhe në pajtim me Rregulloren e Procedurës dhe të Provave.”

⁶ KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, *Konferenca Përgatitore për Gjykim*, 28 nëntor 2025.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00601, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë mbi Procesin e Informimit të Dëshmitarëve dhe Qasjes ndaj Përgatitjes së Dëshmitarëve* (“Parashtrimet e ZPS-së mbi Informimin dhe Prezantimin e Dëshmitarëve”), 4 dhjetor 2025, konfidenciale; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 dhjetor 2025, F00601/RED.

⁸ KSC-BC-2023-12, F00602, Gjykatësi i Vetëm, *Urdhër për Planifikimin e Fillimit të Gjykimit*, 4 dhjetor 2025, publik.

III. DISKUTIM

8. Gjykatësi i Vetëm, pasi shqyrtoi parashtrimet e palëve, miraton këto udhëzime për zhvillimin e gjykimit në çështjen gjyqësore aktuale. Këto udhëzime do të kuptohen si plotësuese të kornizës ligjore të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Udhëzuesve të Punës dhe Udhëzimeve të Zyrës Administrative të zbatueshme. Gjykatësi i Vetëm nuk ka trajtuar aspekte që ai i konsideron të trajtuara mjaftueshëm nga Ligji dhe Rregullorja. Nëse është e domosdoshme, gjatë gjykimit mund të lëshohen udhëzime të tjera.

A. KARAKTERI PUBLIK I PROCEDURAVE

9. Në përputhje me karakterin publik të procedurave siç përcaktohet në nenin 40(4) dhe rregullën 120(1), palët duhet të përpiqen të dorëzojnë parashtrime me shkrim si dokumente publike dhe të kufizojnë informacionin konfidencial sa më shumë që të jetë e mundur në shtojca konfidenciale ose rreptësisht konfidenciale. Parashtrimet gojore dhe paraqitja e provave duhet të formulohen dhe organizohen për të minimizuar, për aq sa është e mundshme, seancat private ose të mbyllura sipas rregullës 120(3).

10. Palët mund t'i referohen parashtrimeve konfidenciale në seancë të hapur, me kusht që kjo të mos e zhbëjë qëllimin e atij klasifikimi. Nëse ndonjëra nga palët beson se në seancë publike është nxjerrë informacion konfidencial që kërkon redaktim, ajo duhet t'i dërgojë menjëherë një mesazh elektronik administratorit të caktuar të çështjes ku tregohen konkretisht (duke iu referuar orës së shënuar ose numrave të rreshtave të transkriptit në kohë reale) fragmentet që mund të kërkojnë redaktim.

11. Palët dhe Zyra Administrative duhet të dorëzojnë versionet e redaktuara publike dhe/ose konfidenciale të parashtrimeve jo më vonë se tri (3) ditë pas parashtrimit fillestar. Kur arsyet për klasifikimin fillestar nuk ekzistojnë më, pala

parashtruese ose, sipas rastit, Zyra Administrative, duhet të kërkojnë riklasifikimin e tyre, siç përcaktohet sipas rregullën 82(5).

12. Palët dhe pjesëmarrësit udhëzohen të dorëzojnë parashtrime *ex parte* vetëm kur është rreptësisht e domosdoshme. Çdo parashtrim *ex parte* duhet të fillojë me arsyetimin për klasifikimin *ex parte* të parashtrimit, dhe parashtrimi mund të refuzohet *in limine* nëse nuk jepet një arsyetim i mjaftueshëm. Palët duhet të presin që çdo parashtrim *ex parte* mund të riklasifikohet më pas si *inter partes*, nëse dhe kur arsyetimi për dorëzimin *ex parte* nuk ekziston më.

13. Palët dhe Zyra Administrative udhëzohen të rishikojnë transkriptet e seancave gjyqësore me qëllim vlerësimin nëse mund të hiqet ndonjë redaktim i zbatuar gjatë seancave, ose nëse transkriptet mund të riklasifikohen si publike. Palët dhe Zyra Administrative duhet të dorëzojnë një parashtrim të përbashkët mbi këtë aspekt, në një dosje të konsoliduar, brenda dy (2) javësh nga përfundimi i çdo blloku dëshmish. Nëse palët dhe Zyra Administrative nuk pajtohen për heqjen e redaktimeve të caktuara, kjo duhet të përshkruhet në parashtrime të përbashkëta me qëndrimet përkatëse të arsyetuara. Gjykatësi i Vetëm do të vendosë për heqjen e redaktimeve dhe/ose riklasifikimin e transkripteve, në përputhje me rregullat 80(1) dhe 84(1).

B. GJUHA E PUNËS

14. Vendimi për Gjuhën e Punës i 11 dhjetorit 2024 mbetet i zbatueshëm.⁹

⁹ KSC-BC-2023-12, F00076, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Working Language](#), (Vendimi për Gjuhën e Punës), 11 dhjetor 2024, publik.

C. NXJERRJA E MATERIALEVE DHE KUFIZIMET NDAJ NXJERRJES SË MATERIALEVE

15. Përveç nëse përcaktohet ndryshe, mbetet i zbatueshëm regjimi që përcakton nxjerrjen e materialeve dhe kufizimet ndaj nxjerrjes së materialit.¹⁰

D. RADHA E PARAQITJES SË PROVAVE

16. Çdo palë duhet t'i paraqesë provat, nëse ka, sipas radhës së përcaktuar në rregullën 127(2). Nëse ekipet e Mbrojtjes nuk pajtohen, ato do t'i paraqesin provat e tyre sipas renditjes së të akuzuarve në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar.¹¹

E. PROVAT QË NUK JANË PJESË E DËSHMIVE

17. Pranueshmëria e provave që nuk janë pjesë e dëshmive të paraqitura nëpërmjet një dëshmitari në përgjithësi do të vendoset menjëherë pasi ato të jenë përdorur me një dëshmitar ose, nëse marrja në pyetje nga pala jothirrëse mund të ndihmojë në përcaktimin e pranueshmërisë, në përfundim të gjithë dëshmisë së dëshmitarit.

18. Provat që nuk janë pjesë e dëshmive mund të paraqiten për pranim edhe me anë të parashtrimeve me shkrim. Pranueshmëria e një materiali të tillë do të vendoset para ose gjatë gjykimit. Çdo kërkesë e tillë duhet:

- (i) të japë një përshkrim të shkurtër të secilës prej provave materiale të propozuara;

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00100, Gjykatësja Procedurës Paraprake, [Framework Decision on Disclosure of Evidence and Related Matters](#), (Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje në lidhje me To), 20 dhjetor 2024, publik.

¹¹ KSC-BC-2023-12, F00264, Prokurorja e Specializuar, [Submission of Amended Confirmed Indictment](#), (Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), 16 prill 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale (ku përfshihet versioni konfidencial i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar), dhe [Annex 2](#), (Shtojca 2) publike (ku përfshihet versioni i redaktuar publik i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar).

(ii) të japë konkretisht relevancën e provës materiale të propozuar duke përfshirë, sipas rastit, përmes referimit në paragrafin ose paragrafët përkatës të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, dhe bazën e vlerës provuese të saj; dhe

(iii) të japë tregues të autenticitetit të provës materiale të propozuar.

19. Palët që kërkojnë pranimin si prova të dokumenteve, videove ose materialeve të tjera të gjata, prej të cilave vetëm një pjesë është relevante, duhet të japin konkretisht pjesët që propozojnë për pranim. Nëse kërkohet pranimi i plotë, pala duhet të japë arsyet pse është i përligjur pranimi i plotë i çdo dokumenti voluminoz.

F. DËSHMITARËT

1. Masat mbrojtëse

20. Çdo vendim i lëshuar në këtë çështje gjyqësore nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në lidhje me masat mbrojtëse për dëshmitarët mbetet në fuqi.¹² Palët duhet të dorëzojnë çdo kërkesë tjetër për masat mbrojtëse për dëshmitarët që synojnë të thërrasin sipas rregullës 80 jo më vonë se kur të dorëzojnë listat e tyre përfundimtare të dëshmitarëve. Masat mbrojtëse të kërkuara duhet të jenë të qarta. Kur një dëshmitar e informon palën thirrëse se ai ose ajo nuk dëshiron më të ketë masa mbrojtëse, pala thirrëse duhet të njoftojë menjëherë ZMMD-në dhe Gjykatësin e Vetëm, dhe të lehtësojë përmbushjen e kërkesave për heqjen dorë sipas rregullën 81(6).

¹² KSC-BC-2023-12, F00172, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Masa Mbrojtëse*, 11 shkurt 2025, konfidencial; F00295, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendimi i Dytë për Masa Mbrojtëse dhe Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë*, 12 maj 2025, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

2. Informimi i dëshmitarëve

21. Palët duhet të koordinohen me ZMMD-në në lidhje me të gjitha aspektet e informimit të dëshmitarëve¹³ dhe, për këtë qëllim, duhet të ndjekin Udhëzuesit e Punës të Zyrës Administrative 19/Rev1¹⁴ dhe KSC-BD 40,¹⁵ Protokollin e Zyrës Administrative KSC-BD-20,¹⁶ Udhëzimet e Zyrës Administrative KSC-BD-41¹⁷ dhe KSC-BD-42/Rev3.¹⁸ Gjithashtu dhe në çdo rast, duhet të respektohen afatet dhe procedurat e mëposhtme.

- (i) Pala thirrëse duhet të njoftojë ZMMD-në lidhur me listën e dëshmitarëve që synon të thërrasë, si dhe rendin, kohën dhe mënyrën e paraqitjes së tyre para Gjykatësit të Vetëm, jo më vonë se **njëzetën (21) ditë** para fillimit të bllokut të dëshmimeve gjatë të cilit ata pritet të paraqiten dhe më pas duhet të informojë menjëherë ZMMD-në nëse lind ndonjë rrethanë që e bën të domosdoshme ndryshimin e kalendarit të parashikuar;
- (ii) Kontakti midis dëshmitarit dhe çdo pale në çështje ndalohet që nga momenti kur dëshmitari bën deklaratën solemne sipas rregullës 141(2) deri në përfundimin e dëshmisë së tij, pavarësisht se ku banon ose nga ku jep dëshminë; dhe

¹³ Gjykatësi i Vetëm e kupton se informimi i dëshmitarëve përfshin "informacionin dhe mbështetjes e ZMMD-së për dëshmitarët para dëshmisë së tyre, në përputhje me detyrimet e saj sipas nenit 34(8) të Ligjit dhe rregullave 27 dhe 80(8) të Rregullores" (*shih* KSC-BC-2023-10, F00595, *Vendim mbi Informimin e Dëshmitarëve*, 13 nëntor 2024, publik, para. 22).

¹⁴ Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Vlerësimet Psikologjike dhe Mbështetja në Dhënien e Dëshmisë, KSC-BD-19-Rev1, 9 shkurt 2022.

¹⁵ Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Procedura Standarde për Ndhimën dhe Pagesat për Dëshmitarët që Paraqiten para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-40-Rev1, 7 tetor 2022.

¹⁶ Protokoll i Zyrës Administrative, Vlerësimi i Nevojës për Mbështetje dhe Masat Mbështetëse për Dëshmitarët Para Udhëtimit, KSC-BD-20, 18 tetor 2019.

¹⁷ Udhëzim i Zyrës Administrative, Përlllogaritja e Pagesës Ditore për Jetesë për Dëshmitarët që Paraqiten para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-41-Rev1, 7 tetor 2022.

¹⁸ Udhëzim i Zyrës Administrative, Udhëzime të ZMMD-së lidhur me shërbimet për dëshmitarët që paraqiten para Dhomave të Specializuara, KSC-BD-42-Rev3, 27 shtator 2024, me Shtojcat 1-2.

(iii) Dëshmitarët që janë punonjës të një pale ndalohen rreptësisht të diskutojnë çdo aspekt që lidhet me çështjen gjyqësore me kolegët ose çdo person tjetër ndërsa janë nën betim, por mund të komunikojnë me kolegët për aspekte që nuk kanë lidhje me çështjen nëse kjo është e domosdoshme për shkak të detyrave urgjente që lidhen me çështje të tjera.¹⁹

22. Rregulli i mësipërm nuk ndalon kontaktet midis një dëshmitari dhe palës thirrëse para bërjes së deklaratës solemne.²⁰ Megjithatë, çdo rregull me zbatim të përgjithshëm në lidhje me takimet midis palëve dhe dëshmitarëve, duke përfshirë në lidhje me detyrimet për të marrë deklaratë dhe kohën e nxjerrjes së deklaratave, ose që rrjedhin nga neni 17 i Kodit të Etikës Profesionale, vazhdojnë të zbatohen për çdo kontakt të palëve me dëshmitarët pavarësisht kohës së tyre.

3. Marrja në pyetje me videokonferencë dhe marrja në pyetje e dëshmitarëve jashtë vendit ku mbahet gjykimi

23. Kërkesat për marrjen në pyetje të një dëshmitari me videokonferencë në përputhje me rregullat 144 ose 145 duhet të bëhen të paktën **21 ditë** para fillimit të bllokut të dëshmive gjatë të cilit dëshmitari parashihet të thirret si dëshmitar. Në rastin e parë, pala thirrëse duhet t'i japë Administratores dhe Gjykatësit të Vetëm informacionin e kërkuar sipas Udhëzuesit të Punës të Zyrës Administrative për Videolidhjet. (KSC-BD-23/COR).

4. Marrja në pyetje e dëshmitarëve

(a) Rendi i marrjes në pyetje

24. Dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja së pari do të merren në pyetje nga ZPS-ja dhe më pas nga çdo ekip i Mbrojtjes që dëshiron të marrë në pyetje dëshmitarin sipas renditjes së përcaktuar në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, përveç nëse palët

¹⁹ Parashtrimet e ZPS-së lidhur me Informimin dhe Paraqitjen e Dëshmitarëve, para. 9-12.

²⁰ *Shih* KSC-BC-2023-10, F00595, Trupi Gjyqësor I, *Vendim mbi Informimin në Tërësi të Dëshmitarëve*, 13 nëntor 2024, publik, para. 30.

kanë rënë dakord ndryshe. Dëshmitarët e thirrur nga Mbrojtja së pari do të merren në pyetje nga pala thirrëse, më pas nga ekipet e tjera të Mbrojtjes sipas renditjes së përcaktuar në Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, përveç nëse palët kanë rënë dakord ndryshe, dhe më pas nga ZPS-ja.

25. Gjykatësi i Vetëm mund të ndryshojë rendin e marrjes në pyetje, kur kërkohet prej interesave të drejtësisë.

(b) Marrja në pyetje nga pala thirrëse

26. Palët duhet të informojnë lidhur me rendin e synuar të dëshmitarëve të paktën **21 ditë** para bllokut të dëshmimeve në të cilin dëshmitarët planifikohen të dëshmojnë, së bashku me listën paraprake të provave materiale të propozuara që do të përdoren me secilin dëshmitar, përditësimin e kohës së parashikuar për marrjen në pyetje nga pala thirrëse, nëse ata do të dëshmojnë në sallë apo me videokonferencë, dhe një përmbledhje të aspekteve, fakteve dhe rrethanave mbi të cilat ata do të dëshmojnë, nëse informacioni tashmë nuk është dhënë. Lista përfundimtare e provave materiale që do të përdoret me secilin dëshmitar duhet të dorëzohet **shtatë (7) ditë** para datës së parapara të fillimit të dëshmisë së dëshmitarit. Jo më vonë se **48 orë** para se dëshmitari të jetë planifikuar të fillojë dëshminë e tij, pala thirrëse duhet të ngarkojë radhën përfundimtare të paraqitjes së provave në *Legal Workflow* duke përfshirë të gjitha dokumentet që ajo synon të përdorë me dëshmitarin. Afatet në lidhje me kohën e njoftimit të dokumenteve të përcaktuara duhet të llogariten nga momenti më i hershëm i mundshëm kur dëshmitari mund të fillojë të japë dëshminë.

27. Pala paraqitëse duhet të njoftojë Gjykatësin e Vetëm, palët kundërshtare dhe Zyrën Administrative sa më shpejt të jetë e mundur për çdo ndryshim në rendin e dëshmitarëve. Pala paraqitëse duhet gjithashtu të sigurojë që, në përfundim të dëshmisë së një dëshmitari, të ketë një dëshmitar tjetër gati për të filluar me dëshminë e tij. Pala paraqitëse duhet të sigurojë që dëshmitari i radhës në rendin e

saj të dëshmitarëve të jetë i disponueshëm për të dëshmuar nëse dëshmia e dëshmitarit të mëparshëm përfundon më herët se sa është parashikuar. Palët këshillohen të konsultohen me ZMMD-në për të siguruar mundësinë e ndryshimeve në rendin e paraqitjes së dëshmitarëve, duke marrë parasysh logjistikën e përfshirë në sigurimin e pranisë në kohë të dëshmitarëve në gjyq.

(c) Marrja në pyetje nga pala jothirrëse

28. Brenda **24 orëve** pas informimit nga pala thirrëse të njoftimit brenda 7 ditëve të provave materiale që do të përdoren me një dëshmitar gjatë pyetjeve të palës thirrëse, çdo palë jothirrëse që synon t'i bëjë pyetje dëshmitarit komunikon elektronik *inter partes* të dërguar në adresën e postës elektronike të administratorit të caktuar të çështjes kohën e pritshme që i nevojitet për të marrë në pyetje dëshmitarin në fjalë përmes mesazhit.

29. Menjëherë pas përfundimit të marrjes në pyetje nga pala thirrëse, pala jothirrëse duhet të nxjerrë për Gjykatësin e Vetëm dhe palët kundërshtare listën e radhës së paraqitjes ku renditen të gjitha dokumentet ose materialet e tjera që synon të përdorë gjatë marrjes në pyetje prej saj. Kjo listë duhet të tregojë numrin e provës materiale të çdo prove të pranuar si provë nga Gjykatësi i Vetëm ose numrin ERN të dokumentit nëse ai nuk është pranuar ende si provë materiale. Radha e paraqitjes duhet të rendisë gjithashtu çdo dokument ose material tjetër që nuk është nxjerrë më parë.

(d) Kundërshtimet

30. Çdo palë që dëshiron të kundërshtojë një pyetje gjatë dëshmisë së një dëshmitari duhet të ngrihet dhe të deklarojë në mënyrë koncize kundërshtimin për Gjykatësin e Vetëm. Kur është e domosdoshme, pala që e bën kundërshtimin duhet të tregojë nëse është e domosdoshme të kalohet në seancë private ose të mbyllur dhe/ose nëse kundërshtimi mund të bëhet në prani të dëshmitarit. Nëse dëshmitari

nuk e kupton anglishten, dëshmitarit mund t'i kërkohet të heqë dëgjueset në vend që të largohet nga salla e gjyqit. Përveç nëse vendoset ndryshe, Gjykatësi i Vetëm do të vendosë gojarisht dhe menjëherë lidhur me kundërshtimin.

31. Një palë që pritet të kundërshtojë dëshminë e një dëshmitari ose një provë materiale të propozuar bazuar në një kundërshtim veçanërisht kompleks faktik ose juridik, kur nuk kishte kohë të mjaftueshme të disponueshme për ta bërë kundërshtimin me anë të një parashtrimi me shkrim, duhet të japë njoftim paraprak lidhur me natyrën e kundërshtimit sa më shpejt të jetë të mundur me mesazh elektronik për të gjitha palët dhe përmes adresës së postës elektronike të administratorit të caktuar të çështjes. Gjykatësi i Vetëm do të vendosë lidhur me kundërshtimin pasi të ketë dëgjuar palët në gjykatë.

(e) Aspekte të përgjithshme

32. Pala që thërret një dëshmitar përgjithësisht pritet t'i formulojë pyetjet e veta në një mënyrë që nuk sugjeron përmbajtjen e përgjigjeve që do të jepen nga dëshmitari, veçanërisht lidhur me pikat faktike të kontestuara.

33. Palët jothirrëse udhëzohen që të shmangin pyetjet e panevojshme, të komplikuar, jo relevante, ose përsëritëse për dëshmitarët, dhe duhet të marrin parasysh që përkthyesit me gojë duhet të përkthejnë pyetjet dhe përgjigjet për të siguruar dokumentimin e saktë të pyetjeve dhe të përgjigjeve. Gjykatësi i Vetëm aktualisht nuk do të përcaktojë një afat të përgjithshëm për marrjen në pyetje të dëshmitarëve nga palët jothirrëse, por mund, sipas rregullës 143(4), të përcaktojë afate konkrete nëse marrja në pyetje nga palët jothirrëse nuk kryhet në mënyrë efikase. Në këtë aspekt, kur disa ekipe të Mbrojtjes synojnë t'i bëjnë pyetje dëshmitarit, ata inkurajohen të bashkëpunojnë për aq sa është e mundur për të shmangur pyetjet përsëritëse.

34. Gjykatësi i Vetëm mund të lejojë pyetje plotësuese dhe, në raste të jashtëzakonshme, pyetje të palëve jothirrëse pas pyetjeve plotësuese të palës

thirrëse, kur është e domosdoshme të sqarohet dëshmia e dëshmitarit për shkak të pyetjeve të bëra nga palët e tjera. Gjithashtu, palët mund të lejohen të bëjnë pyetje shtesë, nëse Gjykatësi i Vetëm jep leje për këtë, pas pyetjeve që mund t'i jenë bërë dëshmitarit nga Gjykatësi i Vetëm, nëse ato janë të domosdoshme për sqarimin e dëshmisë së dëshmitarit.

5. Dëshmitarët ekspertë

35. Në mungesë të ndonjë udhëzimi tjetër, pala thirrëse e ekspertit duhet të paraqesë dhe të nxjerrë version përfundimtar të aktekspertizës jo më pak se **30 ditë** para fillimit të paraqitjes së provave të saj, e cila, në rastin e Mbrojtjes, do të kuptohet si fillimi i paraqitjes së provave nga çdo ekip i Mbrojtjes.

36. Së bashku me aktekspertizën, pala thirrëse duhet të nxjerrë dhe të paraqesë çdo letër angazhimi ose udhëzime të tjera me shkrim ku përcaktohen termat e referencës për punën e ekspertit, si dhe çdo udhëzim tjetër me shkrim që mund të jetë dhënë.

37. Vendimi mbi cilësimin e dëshmitarit si dëshmitar ekspert mund të shtyhet deri pas përfundimit të dëshmisë së dëshmitarit ekspert.

6. Vetinkriminimi i dëshmitarit

38. Pala thirrëse, sipas rastit, duhet të njoftojë dëshmitarin për mundësinë për vetinkriminim dhe të drejtat dhe procedurën përkatëse sipas rregullës 151. Pala thirrëse gjithashtu duhet t'i japë njoftimin e duhur Gjykatësit të Vetëm lidhur me kërkesat e mundshme për garanci sipas rregullës 151(3).

G. EVIDENTIMI I PËRDORIMIT TË KOHËS

39. Zyra Administrative është përgjegjëse për evidentimin e kohës që përdoret gjatë dhënies së dëshmisë prej çdo dëshmitari:

- (i) nga pala thirrëse për marrjen në pyetje të dëshmitarit;

- (ii) nga çdo palë jothirrëse për marrjen në pyetje të dëshmitarit;
- (iii) nga çdo palë që bën pyetje plotësuese ose pyetje të tjera sqaruese;
- (iv) nga Gjykatësi i Vetëm si rezultat i bërjes së pyetjeve për dëshmitarin; dhe
- (v) për të gjitha aspektet e tjera, përfshirë aspekte procedurale dhe administrative.

40. Koha e shpenzuar për trajtimin e një kundërshtimi nuk do të llogaritet si kohë e shpenzuar nga asnjëra nga palët.

41. Zyra Administrative, në bashkëpunim me Gjykatësin e Vetëm, harton raporte të rregullta lidhur me përdorimin e kohës, të cilat duhet t'i jepen periodikisht palëve.

42. Gjykatësi i Vetëm mund të nxjerrë urdhra të tjerë, nëse është e domosdoshme, në lidhje me kohën e përdorur dhe të disponueshme për ZPS-në ose Mbrojtjen.

H. PJESËMARRJA NGA DISTANCA E TË AKUZUARVE

43. Çdo i akuzuar që gjykohet në gjendje të lirë mund të kërkojë që t'i ndjekë seancat me videolidhje,²¹ me kusht që Mbrojtësi përkatës i tij të jetë fizikisht i pranishëm në seancë.²² Çdo kërkesë e tillë duhet të dorëzohet jo më vonë se katër (4) javë përpara fillimit të bllokut përkatës të dëshmive. Përgjigjet mund të dorëzohen brenda pesë (5) ditësh, kundërpërgjigjet mund të dorëzohen brenda tri (3) ditësh.

²¹ Gjykatësi i Vetëm nënvizon se kur jepet dëshmi nga Kosova, mbeten në fuqi të njëjtat kushte për të akuzuarit përkatës, *shih* KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse*, 29 nëntor 2024, konfidencial, para. 100-101; versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më 19 dhjetor 2024, F00037/RED; *Vendimi i Dytë për Masa Mbrojtëse dhe Trajtimin e Informacionit Konfidencial dhe Kontakteve me Dëshmitarë*, para. 46; F00599, Gjykatësi i Vetëm, *Vendimi i Gjashtë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt*, 3 dhjetor 2025, konfidencial dhe *ex parte*, para. 50-51; versioni i redaktuar publik u dorëzua më 10 dhjetor 2025, F00599/RED.

²² Rregulla 68(2).

I. DOSJET GJYQËSORE PËRFUNDIMTARE

44. Dosjet gjyqësore përfundimtare do të dorëzohen në pajtim me rregullën 134(b), në datën e përcaktuar nga Gjykatësi i Vetëm jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të paraqitjes së provave të çështjes. Duke marrë parasysh këtë afat të shkurtër ligjor, Gjykatësi i Vetëm nuk gjykon se përcaktimi i një afati për ZPS-në për të dorëzuar e para dosjen e saj, siç kërkohet nga Mbrojtja,²³ është i realizueshëm. Megjithatë, duke pasur parasysh parashtrimet e Mbrojtjes në lidhje me nevojën për t'iu përgjigjur argumenteve të ZPS-së, palët do të ftohen gjithashtu të paraqesin dosjet e kundërpërgjigjes për t'u siguruar që kanë mundësinë që t'i përgjigjen me shkrim çdo argumenti të ngritur nga pala kundërshtare. Kufizimet lidhur me numrin e faqeve dhe kohën do të vendosen nga Gjykatësi i Vetëm në kohën e duhur.

J. SISTEMI *LEGAL WORKFLOW*

45. Ky gjykim do të zhvillohet duke përdorur sistemin *Legal Workflow* të gjykatës. Të gjitha dokumentet do të trajtohen përmes këtij sistemi. Palët mund të përdorin kopje të printuara të një dokumenti vetëm kur ato nuk kanë qenë në gjendje, për shkak të rrethanave të paparashikuara, të ngarkojnë një dokument në *Legal Workflow* ose kur përdorimi i tij fizik në gjykatë është i domosdoshëm për shkak të natyrës së tij të veçantë.

46. Kur lejohet përdorimi i kopjeve të printuara të një dokumenti, pala që paraqet materialin është përgjegjëse për të siguruar kopje për Gjykatësin e Vetëm, dëshmitarin, palët kundërshtare, Zyrën Administrative dhe përkthyesit me gojë.

IV. VENDIM

47. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Vetëm:

²³ Parashtrimet e Thaçit, para. 36; Parashtrimet e Smakajt, para. 14; Parashtrimet e Kilajt, para. 17; Parashtrimet e Fazliut, para. 14.

- a. **MIRATON** udhëzimet e mësipërme në lidhje me zhvillimin e gjykimit në çështjen aktuale; dhe
- b. **UDHËZON** Mbrojtjen e Thaçit, Mbrojtjen e Smakajt dhe Mbrojtjen e Kuçit të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të parashtrimeve të tyre në lidhje me këtë vendim deri **të premtën, 30 janar 2026.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Kristofer Gosnell
Gjykatës i Vetëm

E hënë, 22 dhjetor 2025

Në Hagë, Holandë.